LAJME / SHQIPËRI

Vrasje e rëndë në Velipojë, katër të vdekur dhe dy të plagosur

7 komente



15 orë

Një vrasje e rënë ka ndodhur mbrëmë në Velipojë, ku si pasojë e një konflikti të çastit, i cili është përshkallëzuar në përdorim të armës së zjarrit, kanë mbetur të vrarë shtetasit K. V. 59 vjeç, Xh. G. 25 vjeç , E. G. 38 vjeç dhe M. Z. 20 vjeç, si dhe janë plagosur shtetasit H. V. 54 vjeç, dhe E. D. 17 vjeç, të cilët dyshohen si autorë të përfshirë në konfliktin e armatosur.

Sipas policisë në Shkodër, ngjarja e rënë ka ndodhur rreth orës 00:30, në Pulaj Plazh, Velipojë.

"Për hetimin dhe zbardhjen e ngjarjes menjëherë është ngritur një grup posaçëm hetimor me specialistë të strukturave hetimore në DVP Shkodër dhe të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve ndaj Personit dhe Jetës në Departamentin e Policisë Kriminale në Policinë e Shtetit, nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në ndihmë të Policisë vendore ka shkuar FNSH Shkodër dhe një grup i Forcave Speciale Renea. Grupi hetimor po punon për zbardhjen e dokumentimin e plotë të rrethanave dhe shkakut të kësaj ngjarjeje", thuhet në njoftim.

Velipojë | Vrasje

Lajme | Telegrafi

Më të lexuarat në Lajme



Nga debati për rërën te krismat – si ndodhi tragjedia e Velipojës



Fevziu për vrasjen e 20-vjeçarit në Velipojë: Vendi ku grabitësi quhet i zoti dhe ai që punon i "paaftë"



Flet mes lotëve babai i dy vëllezërve të vrarë në Velipojë



Osmani: Kufijtë etnikë, ide e rrezikshme

TELEGRAFI sh.p.k.
Rr. Rexhep Mala, Aktash, Nr.34, Prishtinë, Kosovë info@telegrafi.com 038 224 093 - +383 48 222 355

Ky portal mirëmbahet nga kompania "Telegrafi". Materialet dhe informacionet në këtë portal nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër për qëllime përfitimi, pa miratimin e drejtuesve të "Telegrafit". Për ta shfrytëzuar materialin e këtij portali obligoheni t'i pranoni Kushtet e përdorimit.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © 2006-2021 Portali Telegrafi